



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.269/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj -anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 01.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

- I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.269/2025 e datës 30.01.2025
- II. Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 3,000.00 (tremijë) euro.
- III. Detyrohet Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 30.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës- (PDK), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se Kandidati për deputet nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Ilir Gashi, me datën 29.01.2025 ka postuar një fotografi në llogarinë e tij në Facebook me tekst shoqërues “*Me këtë rast i përkujtuam edhe zotimet për Qeverinë Kurti 3 me të cilën parashikohet mbështetja e bizneseve me subvencionimin e pagave për 6 muaj në punësimin e grave mbi 40 vjeç.....*” të realizuar me hapësirat e brendshme të bashkisë islame, në kundërshtim me dispozitat ligjore zgjedhore duke shfrytëzuar kështu burimet dhe institucionet fetare për qëllime elektorale dhe duke bërë thirrje që të votohet subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV). Sipas

parashtruesit të ankesës theksohet se me këtë veprim është shkelur nenin 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Rregullores Zgjedhore 07/2024.

Të njëjtit theksojnë se për natyrën e njëjtë të shkeljes me vendimin e PZAP-it është gjobitur subjekti politik PDK.

PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për ankesën e paraqitur kundër tyre.

Në përgjigjen në ankesë të datës 31.01.2025, subjekti politik LVV thekson dispozitat ligjore të cilave i referohet pala ankuese thekson se qëllimi i ligjvënësimit ka qene qe fushatës zgjedhore mos ti jepet karakter fetar duke u ndërlidhur me nenin 8 te Kushtetutës se Kosovës i cili mban distancë mes shtetit dhe religjioneve të caktuara.. Te njëjtit ne përgjigje ne ankese theksojnë se shkelja do të ishte pjesëmarrja aktive e organizatave fetare ne fushate zgjedhore dhe jo pritja e subjekteve ne takime te personave qe veç janë ne fushate zgjedhore aktivisht. Dispozitat ligjore sanksionojnë pjesëmarrjen e këtyre zyrtareve fetar ne fushate dhe jo priten e pjesëmarrësve ne takim. Te njëjtit per me tepër theksojnë se ky takim kishte edhe karakter kulturor ku u promovua toleranca ndër fetare ne komunën e Prizrenit.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

Ankesa është bazuar

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore dhe përgjigjen në ankesë, ka gjetur se kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik LVV, Ilir Gashi në postimin e 29.01.2025 në llogarinë e tij të facebook-ut të me qëllim të përfitimit të votave ka postuar duke bërë fushatë me përfaqësues fetar dhe të punësuarit në objektin e Bashkësisë Islame në Prizren. Nga prova materiale e bashkangjitur ankesës, nga subjekti politik PDK, dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka vlerësuar se nga ana e kandidatit për deputet dhe anëtarëve tjerë nga radhët e subjektit politik, LVV, është shkelur Rregulla Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, pasi që kandidatët në fjalë, me qëllim të promovimit të kandidaturës së tyre për deputet, ka bërë fushatë zgjedhore me përfaqësues fetar, duke i përfshirë në fushatë zgjedhore përfaqësues fetar nga Bashkësisë Islame në Prizren veprim ky i cili bie në kundërshtim me dispozitën e nenit 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Rregullores Zgjedhore 07/2024 që përcakton se në fushatën zgjedhore nuk mund të përfshihen kategoritë e personave të punësuar në organizata bamirëse dhe fetare.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e lartpërmendura janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi si të bazuara, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se

nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Pretendime ne përgjigje ne ankesë se këto dispozita ligjore i referohen përfaqësuesve fetare, per Panelin këto janë te pabazuara per faktin se kandidati i subjektit politik LVV me stafin e tij kane vizituar zyrat e bashkësisë Islame ne Prizren dhe kjo vizitë e tyre ka pasur karakter te fushatës zgjedhore me ç 'rast te njëjtit kane shpalosur programin e tyre qeverisës për Qeverinë Kurti 3.

Gjithashtu Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor. Kjo konsiston në faktin se subjekti politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj përfshirja e kandidatit dhe anëtarëve të tjerë të subjektit politik te LVV për fushatë zgjedhore është takuar me përfaqësues fetar është në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Rregullores Zgjedhore 07/2024.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nen parafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, dhe nenit 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Rregullores Zgjedhore 07/2024, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.269/2025 më datën 01.02.2025

Kryesuese i Panelit
Skender Çoçaj



Këshilla Juridike: Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.